REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 56/5 Prot. Tiranë, më 09/02/2023

**VENDIM**

**Nr. 11 , datë 09 / 02 /2023**

**MBI**

**"PËRCAKTIMIN E PIKËZIMIT NË KONKURSET E PRANIMIT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024"**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, nenin 74, 76 e vijim të ligjit nr. 80/2015, për "*Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nisur dhe nga propozimet e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe më konkretisht shkresës me nr. 35/1 Prot., datë 30.01.2023 të FM dhe nr. 56/2 Prot., datë 30.01.2023 të UART, shkresës me nr. 12 Prot., datë 20.01.2023 të FAS dhe 56/1 Prot., datë 24.01.2023 të UART dhe shkresës me nr. 10 Prot., datë 31.01.2023 të FAB dhe nr. 56/3 Prot., datë 31.01.2023 të UART, pasi i mori në shqyrtim dhe i diskutoi ato, me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Pikët maksimale për konkurrim në një nga programet e studimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në Fakultetet e Universitetit të Arteve të jenë **200 pikë**, me këtë ndarje:

   a) 30% e totalit ose **60 pikë** i takojnë notës mesatare të viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe provimeve të Maturës Shtetërore;
   b) 70% e totalit ose **140 pikë** i takojnë rezultateve të konkursit të pranimit për secilin program të ofruar nga Universiteti i Arteve;

2. Kufiri minimal i pranimit të konkurrentëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor të jetë **90 pikë**.

3. Formula e llogaritjes së pikëve të konkursit të pranimit në Universitetin e Arteve për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në vitin akademik 2023-2024, të jetë si më poshtë:

a) **P** Pikët e përgjithshme për konkurrim: **200 totali**
b) **NMP** Nota mesatare e përgjithshme ose 30 % e totalit të pikëve: **60 pikë**
c) **PK** Pikët e konkursit të pranimit ose 70 % e totalit të pikëve: **140 pikë**
d) Formula e llogaritjes së pikëve: **P = (NMP/60 x 0.3 + PK/140 x 0.7) x 200**

4. Pikët maksimale për konkurrim në një nga programet e studimit në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve/ Master Shkencor dhe Master Profesional në Fakultetet e Universitetit të Arteve të jenë **100 pikë**.

5. Ndarja e pikëve për Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Arteve të Bukura të jetë si më poshtë:

   a) Nota mesatare e ponderuar: **30** (tridhjetë) pikë;
   b) Vlerësimi i dosjes personale: **30** (tridhjetë) pikë;
   c) Bashkëbisedim me kandidatin: **40** (dyzet) pikë;

6. Ndarja e pikëve në Fakultetin e Muzikës për secilin program studimi të ofruar, në përkatësi të elementeve kryhet nga komisioni i vlerësimit.

7. Kufiri minimal i pranimit të konkurrentëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve/ Master Shkencor dhe Master Profesional të jetë **40 pikë**.

8. Ky vendim t'i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

9. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, në portalin U-Albania dhe tek transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Kastriot ÇAUSHI** **Prof. Najada HAMZAJ**

**Prof. Dr. Isak SHEHU** **Prof. Petrit MALAJ**

**Prof. Artan PEQINI** **Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)**

| | |
|---|---|
| Prof. Arben LLOZI | Prof. Ilir MARTINI |
| Prof. Asoc. Dorian ÇENE | Prof. Gazmend GJOKA |
| Prof. Asoc. Kastriot TUSHA | Prof. Dr. Erald BAKALLI |
| Prof. Endri SINA | Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI |
| Prof. Asoc. Albes FUSHA | Erlind FUSHA (Student FAB) |
| Sindi ZDRAVA (Studente FM) | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

Nr 56/1 Prot
24/01/2023

Për evadim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**
**DEKANI**

Nr. 12 Prot. Tiranë, më 20/01/2023

**Lënda:** Dërgohet dokumentacion për zhvillimin e konkursit për vitin akademik 2023-2024.

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof.Kastriot ÇAUSHI**

Zoti Rektor,

Mbështetur në shkresën e tuaj me nr 56 prot. datë 18/01/2023 me lëndë *"Kërkesë për konkurset e pranimit për vitin akademik 2023-2024"*, po ju dërgojmë për miratim në Senatin Akademik dokumentacionin përkatës si më poshtë:

1. Procedurat pikëzimit në konkursin e pranimit për dy ciklet e studimit për vitin akademik 2023-2024 si dhe formulën e llogaritjes së pikëve.
2. Propozim për kuotat e pranimit për dy ciklet e studimit për vitin akademik 2023-2024.
3. Propozimin për tarifën e konkurrimit, tarifën e rregjistrimit, si dhe tarifën e shkollimit për programet e studimit që ofron FAS në dy ciklet e studimit për vitin akademik 2023-2024.
4. Propozimin për përcaktimin e vlerës monetare të studimit, për ndjekjen e programeve të studimit për dy ciklet e studimit në FAS për vitin akademik 2023-2024.
5. Propozimin për përcaktimin e vlerës monetare të studimit, për ndjekjen e një programi të dytë për dy ciklet e studimit në FAS për vitin akademik 2023-2024.

**D E K A N I**

**Prof. Petrit MALAJ**

**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**



Konc: Ema Gurra
Kopje: 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**
**DEKANATI**

Nr. ___ Prot. Tiranë, më ___/01/2023

**Lënda:** *Mbi konkurset për pranimin e studentëve në dy ciklet e studimit për vitin akademik 2023 - 2024*

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**
**Prof.Kastriot ÇAUSHI**

Z. Rektor,

Po ju dërgojmë propozimet e departamenteve të FAS për miratim në Senatin Akademik lidhur me procedurat e pikëzimit në konkursin e pranimit per dy ciklet e studimit për vitin akademik 2023-2024.

1. **-Pikët maksimale në konkurset e pranimit në ciklin e parë** të studimeve bachelor për vitin akademik 2023- 2024 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Artit Skenik të jenë **200 pikë. (dyqindë)**
2. Ndarja e pikëve në këtë cikël të studimeve në përqindje të jetë në dy zëra si më poshtë:

   a- **30 % e pikëve të shumës maksimale të jenë nga nota mesatare** e viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore.

   b- **70 % e pikëve të shumës maksimale të jenë nga rezultatet e Konkursit.**

3. Nisur nga totali i pikëve që propozojmë si dhe nga ndarja e përqindjeve të të dy zërave të mësipërm del që pikët maksimale të fituara nga nota mesatare e viteve të studimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore të jenë 60 pikë.
   Ndërsa pikët maksimale të fituara nga konkursi i pranimit të jenë 140 pikë.

4. **Pikët minimale** që duhet të marrë një konkurent për t'u shpallurr si fitues **në ciklin e parë të studimeve bachelor të jenë 90 (nëntëdhjetë) pikë.**

5. **-Pikët maksimale në konkurset e pranimit në ciklin e dytë** të studimeve Master për vitin akademik 2023- 2024 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Artit Skenik të jenë **100 (njëqindë) pikë**.

6. Vlerësimi për këtë cikël të studimeve ka në bazë dy faza:
   a- Faza e parë: shqyrtimi i dosjes së kandidatit përbëhet nga dy vlerësime:

- Nota mesatare e ponderuar 30 (tridhjetë) pikë
- Shqyrtimi i dosjes personale 30 (tridhjetë) pikë

   b- Faza e dytë: bashkëbisedim me kandidatët. Vlerësimi maksimal për këtë fazë është 40 (dyzetë) pikë.

7. **Pikët minimale** që duhet të marrë një konkurent për t'u pranuar si fitues në ciklin e dytë të studimeve Master, **të jenë 40 dyzetë) pikë**.
8. Formula e llogaritjes së pikëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor të jetë si më poshtë:

   - P pikët e përgjithshme në konkurim 200 pikë
   - NMP nota mesatare e përgjithshme ose 30% e totalit të pikëve 60 pikë
   - PK pikët e konkursit të pranimit ose 70% e totalit të pikëve 140 pikë
   - Formula e llogaritjes së pikëve: **P= (NMP/60 X 0.3 +PK/140 X 0.7) X 200**

DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI
**Prof. Gazmend GJOKA**

DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI, KOREOGRAFI
**Prof.asoc.Taulant PUSTINA**

DEPARTAMENTI REGJI, REGJI FILMI DHE TELEVIZIONI
**Prof.asoc. Alert ÇELOALIAJ**

ZV/DEKANI TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK
**Prof. Ilir MARTINI**

**D E K A N I**

**Prof. Petrit MALAJ**

Nr. 56/3 Prot
31/01/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**
**DEKANI**

Nr. 10 Prot Tiranë,më 31/1/2023

**Lënda:** *Mbi konkurset për pranimin e studentëve në dy ciklet e studimit në FAB për vitin akademik 2023 - 2024*

**Drejtuar:** **ZV./REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**
**Prof.dr. Erald BAKALLI**

**Lënda:** Përcjellje e propozimit të tarifave, kuotave dhe pikëzimit me formulë për konkurset e pranimit si dhe tarifave të shkollimit në Ciklin I dhe Ciklin II të Studimit në FAB për vitin akademik 2023-2024.

Bashkëngjitur do të gjeni propozimet e tarifave, kuotave dhe pikëzimit me formulë të konkursve të pranimit në programet e studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" dhe Ciklit të Dytë – Master në Arte dhe Mësuesi në Fakultetit e Arteve të Bukura për vitin akademik 2023-2024.

**PROF. ARTAN PEQINI**

**DEKAN**

**FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**
**DEKANI**

Nr. 104 Prot                                                  Tiranë, më 31/1/2023

**Lënda:** *Mbi konkurset për pranimin e studentëve në dy ciklet e studimit në FAB për vitin akademik 2023 - 2024*

**Drejtuar:** **ZV./REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**
**Prof.dr. Erald BAKALLI**

Z. Bakalli!

Mbështetur në shkresën Tuaj nr. 56 Prot., datë 18.01.2023 po ju dërgojmë propozimet e departamenteve të FAB për miratim në Senatin Akademik.

1. Pikët maksimale në konkurset e pranimit në ciklin e parë të studimeve **Bachelor** për vitin akademik 2023-2024 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Arteve të Bukura të jenë 200 (dyqindë) pikë.
2. Ndarja e pikëve në këtë cikël të studimeve në përqindje të jetë në dy zëra si më poshtë:

   a- 30 % e pikëve të shumës maksimale të jenë nga nota mesatare e viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore.

   b- 70 % e pikëve të shumës maksimale të jenë nga rezultatet e konkursit.

3. Nisur nga totali i pikëve që propozojmë, si dhe nga ndarja e përqindjeve të të dy zërave të mësipërm, rezulton se **pikët maksimale të fituara nga nota mesatare** e viteve të studimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore duhet **të jenë 60 pikë.**
   Ndërsa **pikët maksimale të fituara nga konkursi** i pranimit **të jenë 140 pikë.**

4. **Pikët minimale** që duhet të marrë një konkurent për t'u shpallur si fitues në ciklin e parë të studimeve bachelor **të jenë 90 (nëntëdhjetë) pikë. (Pikët minimale në konkurs – 30 pikë).**

gjitha programet e studimit që ofron FAB në ciklin e parë të studimeve bachelor gjëndet bashkëlidhur kësaj shkrese.

12. Propozimi për përcaktimin paraprak të tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit si dhe të tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2023-2024, për të gjitha programet e studimit që ofron FAB në ciklin e dytë të studimeve gjëndet bashkëlidhur kësaj shkrese.

| | |
|---|---|
| **Përgjegjësi i Njësisë Bazë Pikturë** | **Dr. Mikel Temo** |
| **Përgjegjësi i Njësisë Arte të Aplikuara** | **Dr. Ermir Hoxha** |
| **Përgjegjësi i Njësisë Bazë Skulpturë** | **Prof. Sadik Spahija** |

**PROF. ARTAN PEQINI**

**DEKAN**

**FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA**

Nr. 56/2 Prot
30/01/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

**Nr. Prot. 35/1** **Tiranë, më 30.01. 2023**

Lënda: Mbi konkruset e pranimit për dy ciklet e studimit për vitin akademik 2023-2024

**ZV.REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Dr. Erald Bakalli**

**I nderuar zoti Zv.Rektor**

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 56, datë 18.01.2023, mbi Konkurset e pranimit për vitin akademik 2023-2024, duke marrë në konsideratë edhe mendimet e përgjegjesave të njësisë bazë porpozojmë si më poshtë:

1. Kufiri maksimal i pikëve për konkurset e pranimit 2023-2024 në të gjitha programet e studimit të Fakultetit të Muzikës të jetë 200 pikë (dyqindë).
2. Pikët minimale që duhet të marrë një konkurent për t'u shpallur si fitues në ciklin e parë të studimeve bachelor të jenë 90 (nëntëdhjetë) pikë.

3. Ndarja e pikëvë në këtë cikës të studimeve në përqitje të jetë në dy zëra si më poshtë:.

a- 30 -% e pikëve të shumës maksimale (200 pikë) të jenë nga nota mesatare e viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe provirneve të maturës shteterore.

b- 70 % e pikëve të shurnës maksimale (200 pikë) nga rezultatet e konkursit.

Nisur nga totali i pikëve që propozojmë si dhe nga ndarja e përqindjeve të të dy zërave të mësipërm del që pikët maksimale të fituara nga nota mesatare e viteve të studimit të shkollës së mesme dhe provimeve të matures shtetërore të jenë 60 pikë. Ndërsa pikët maksimale të fituara nga konkursi i pranimit të jenë 140.

4. Formula e llogaritjes së pikëve për ciklin e parë të studimeve Bachelor të jetë si më poshtë:

**P** --> Pikët e përgjithshme të nevojshme për rankim

**NMP** --> Nota mesatare e përgjithëshme sipas VKM

**PShM** --> Pikët nga mesatarja e Shkollës së Mesme: 30% e 200 pikëve, pra 60 pikë (mesatarja 10)

**PK** --> Pikë konkursi: 70% e 200 pikëve, maksimumi i pikëve 140

**Pragu me 90 pikë**

**Formula:**

| | | |
|---|---|---|
| **Tek - H** | (baras) =G2*6 | shënim: 6 del nga: 60 : 10 |
| **Tek –** | (baras) = Sum(H2;I2) | |

5. Propozimi për përcaktimin paraprak të kuotave në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2023-2024, për të gjitha programet e studimit që ofron Fakulteti i Muzikës në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Bachelor dhe Master gjendet bashkëlidhur kësaj shkrese në tabelën Nr.1.

6. Propozimi për përcaktimin paraprak të tarifës në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2023-2024, për të gjitha programet e studimit që ofron Fakulteti i Muzikës në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Bachelor dhe Master gjendet bashkëlidhur kësaj shkrese në tabelën Nr.2.

7. Përsa ju takon pikave 7 dhe 8, janë jashtë kompetencave tona përsa kohë kanë të bëjnë me kosto financiare të studimeve për të dy ciklet.

Me konsideratë,

| | |
|---|---|
| **Përgjegjës i Njësisë Bazë të Interpretimit** | **Prof. Arben Llozi** |
| **Përgjegjës i Njësisë Bazë të KMDP** | **Prof. Asoc. Dorian Çene** |
| **Përgjegjës i Njësisë Bazë të Kantos** | **Prof. Asoc. Kastriot Tusha** |
| **Zv.dekan i Fakultetit të Muzikës** | **Prof.Asoc. Merita Rexha (Tërshana)** |

**DEKANI**

**Prof. Dr. Isak Shehu**

**FAKULTETI I MUZIKËS**

Konc. M.Tershana,Kopje 4